

Vendim nr. 322 datë 27.12.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 27.12.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 17(F) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **FRAN NIKOLLI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1964, datë 14.05.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtuëshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 33, pika 1, 42, 43, 44, 52, pika 2 dhe 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 shtesë të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Fran Nikolli ka ushtruar detyrën e punonjësit të policisë në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (*IEVP*), Elbasan dhe është larguar nga detyra me urdhrin nr.

2689, datë 19.04.2013 të drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve. Ky largim nga puna është kundërshtuar nga ai në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nëpërmjet kërkesëpadisë, me objekt: anulimin e urdhrit të drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve; detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB) për ta rimarrë në punë dhe pagimin e pagës nga data 19.04.2013 deri në rikthimin në punë; detyrimin e DPB-së për pagimin e pagave të prapambetura; detyrimin t'i paguajë 3 paga mujore për mosrespektim të nenit 143 të Kodit të Punës, 2 paga mujore për mosrespektim të nenit 144 të Kodit të Punës dhe 12 paga mujore për zgjidhjen e kontratës në mënyrë të pajustificuar në kundërshtim me nenin 146 të po atij kodi. Ajo gjykatë, në përfundim të shqyrtimit, me vendimin nr. 4447, datë 24.07.2014, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë; detyrimin e DPB-së t'i paguajë kërkuesit dëmshpërblimin me 7 paga mujore për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës; detyrimin për t'i paguar 2 paga mujore për mosrespektimin e afatit të njoftimit dhe 2 paga mujore për mosrespektimin e procedurës. Në total gjykata ka vendosur dëmshpërblimin e kërkuesit me 11 paga mujore dhe rrëzimin e padisë për pjesën tjetër. Po kështu, gjykata e shkallës së parë ka vendosur edhe ekzekutimin e detyrimit monetar nga DPB-ja me 3 këste brenda afatit njëvjeçar. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim DPB-ja.

2. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 520, datë 12.03.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, shfuqizimin e urdhrit të drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve, dëmshpërblimin e kërkuesit me pagën e një viti, ekzekutimin e vendimit brenda 6 muajve, si dhe rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të kërtimeve. Ajo gjykatë ka arsyetuar se bazuar në vendimin unifikues nr. 31, datë 14.04.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*vendimi unifikues nr. 31/2003*), me anë të ankimit në gjykatë, punonjësi i policisë, por edhe një numër tjetër punonjësish publikë që kanë detyra të caktuara punonjësish shërbimi ndaj shtetit dhe, për shkak të të cilave veprojnë si përfaqësues të shtetit për mbrojtjen e interesave të tij, nuk mund të realizojnë gjyqësisht rikthimin në detyrën që kanë pasur, edhe në qoftë se provohet se janë larguar prej saj pa shkaqe të përligjura. Po kështu, gjykata e apelit e ka vlerësuar të gabuar përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se urdhri i drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve nuk është akt administrativ dhe, për këtë arsye, nuk gëzon mbrojtje gjyqësore, pasi marrëdhënia e punës së paditësit nuk trajtohet me Kodin e Punës, por me ligjin e posaçëm nr. 10032/2008 "Për Policinë e Burgjeve". Sipas gjykatës së apelit, për shkak të natyrës së veçantë që ka marrëdhënia e punës në rastin konkret, do të konsiderohet shërbim publik, ndaj gjyqësisht kërkuesi nuk gëzon rikthim në vendin e mëparshëm të punës, por ka të drejtën e dëmshpërblimit, i cili, duke qenë se nuk

parashikohet në ligjin e posaçëm, do të referohet në Kodin e Punës. Për rrjedhojë, sipas kësaj gjykate, urdhri i drejtorit të DPB-së duhet të shfuqizohet si i nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Ndërsa në lidhje me kërkimet e tjera gjykata ka vendosur rrëzimin si të pambështetura në ligj. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur rekurs DPB-ja, por më pas e ka tërhequr atë.

3. Mbi bazën e këtij vendimi kërkuesi i është drejtuar IEVP-së, Elbasan, duke kërkuar rikthimin në vendin e mëparshëm të punës, kërkesë e cila nuk është pranuar. Duke qenë se kishte paqartësi në lidhje me vendimin, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesë, me objekt sqarimin dhe interpretimin e vendimit të saj nr. 520, datë 12.03.2015, nëse bazuar në këtë vendim ai ka të drejtë ose jo të rikthehet në detyrë, si dhe nëse pala e paditur, duke mos e rikthyer në detyrë, ka vepruar në kundërshtim me ligjin.

4. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 210, datë 15.12.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se vendimin i saj objekt kërkesë është i qartë. Sipas saj, ndaj vendimit nr. 4447, datë 24.07.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë kërkuesi nuk ka paraqitur ankim. Po kështu, për sa i përket rikthimit në punë, sipas asaj gjykate, ky kërkim nuk gëzon mbrojtje ligjore. Në lidhje me dëmshpërblimin e kërkuar sipas Kodit të Punës dhe të pranuar nga gjykata e shkallës së parë, gjykata ka vlerësuar se marrëdhënia e punës së paditësit nuk trajtohet me Kodin e Punës. Referimi në vendimin unifikues nr. 31/2003 është bërë vetëm në lidhje me masën e dëmshpërblimit, në rastin kur gjykata arrin në përfundimin se marrëdhënia e punës është zgjidhur pa shkaqe të ligjshme. Ndërsa për kërkimet e tjera gjykata e apelit ka arsyetuar se ato duhet të rrëzohen për shkak se nuk gjejnë mbështetje ligjore. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1964, datë 14.05.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

6. Në datën 29.10.2024 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij.

II Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

7.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor*, në drejtim të:

- 7.1.1. *Së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi Kolegji Administrativ në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve ka vendosur rrëzimin e rekursit, duke i mohuar të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të qenë i pranishëm gjatë shqyrtimit të çështjes së tij.
- 7.1.2. *Afatit të arsyeshëm për shqyrtimin e çështjes së tij*, pasi rekursi i kërkuarit nuk është shqyrtuar brenda afatit 90-ditor, në kundërshtim me nenin 60 të ligjit nr. 49/2012. Rekursi është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 27.01.2017 dhe shqyrtimi i tij ka përfunduar në datën 14.05.2024.
- 7.2. *E drejta e rikthimit në vendin e punës*, pasi ky veprim duhet të ishte kryer nga drejtori i Përgjithshëm të Burgjeve që prej datës 12.03.2015 kur është dhënë vendimi i gjykatës së apelit, e cila ka vendosur shfuqizimin e urdhrin për largimin e kërkuarit nga detyra.
- 7.3. *E drejta për t'u dëmshpërblyer*, sipas nenit 44 të Kushtetutës, pasi nga akte, veprime ose mosveprime të organeve shtetërore janë shkelur haptazi nenet 143, 144 dhe 146 të Kodit të Punës.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik subjekt i së drejtës, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

9. Si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike

efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, që pretendohet se janë cenuar. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, përmbushja e këtij kriteri është detajuar në dy hipoteza: i) kur kërkuesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive përpara se t’i drejtohet gjykatës; ii) ose kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete juridike efektive në dispozicion.

11. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka ngritur pretendime edhe për cenimin e afatit të shqyrtimit të çështjes së tij nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Për sa i përket këtij pretendimi, Kolegji vëren se nëpërmjet kërkesës së datës 13.11.2018 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë, duke kërkuar përshpejtimin e procedurës gjyqësore.

12. Nga shqyrtimi i akteve të paraqitura nga kërkuesi vërehet se kërkesa drejtuar Gjykatës së Lartë nuk është bazuar në nenet 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*). Për këto të fundit, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se janë mjete juridike që ofrojnë rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese dhe vetëm pasi t’i ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen prej tyre nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, individi mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 44, datë 26.09.2023; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto rrethana, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, për pasojë pretendimi i tij për cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm nuk mund të merret në shqyrtim.

13. Në lidhje me pretendimet e tjera, në kushtet kur Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka më mjet tjetër ankimi ndaj vendimit të kundërshtuar, për rrjedhojë e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

14. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit të së drejtës për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet ajo në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose me njoftimin elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimi i Kolegjit Administrativ është i datës 14.05.2024, ndërsa, ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 29.10.2024, pra jashtë afatit ligjor 4-mujor të parashikuar në ligj. Për qëllime të shqyrtimit paraprak i është

kërkuar informacion Gjykatës së Lartë në lidhje me momentin në të cilin ky vendim është bërë i disponueshëm për palët. Me informacionin e datës 18.12.2024 Gjykata e Lartë ka konfirmuar se vendimi objekt kundërshtimi është bërë i disponueshëm për palët dhe publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 07.06.2024.

16. Ndërkohë, në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri, kërkuesi parashtron se vendimi i Kolegjit Administrativ i është vënë në dispozicion në datën 21.10.2024 dhe për këtë arsye është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, ndërsa nuk ka paraqitur asnjë argument ose provë se në çfarë mënyre është vënë në dijeni në lidhje me të, në datën 21.10.2024. Po kështu, prej tij nuk paraqitet asnjë argument, pretendim ose provë për të provuar se ka qenë në pamundësi për marrjen dijeni të vendimit dhe as në drejtim të pamundësisë për t'u informuar në lidhje me shqyrtimin e çështjes së tij. Po kështu, nga aktet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij shqyrtimi nuk rezulton që ai të ketë lënë të dhënat elektronike të kontaktit, prandaj, në këto kushte, Gjykata e Lartë ka qenë në pamundësi për të njoftuar kërkuesin në lidhje me vendimin e arsyetuar. Për rrjedhojë, vetëm pretendimi se ai ka marrë dijeni për vendimin e kundërshtuar në datën 21.10.2024 nuk është i mjaftueshëm për të provuar në nivel kushtetues se ajo datë duhet të konsiderohet si data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin e kundërshtuar. Për më tepër, Kolegji vëren se ka qenë kërkuesi i cili ka vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë nëpërmjet rekursit, për të cilin ka qenë edhe i interesuar të ndjekë ecurinë e tij.

17. Në këtë kuptim, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka arritur të provojë në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme nga data në të cilën vendimi i Gjykatës së Lartë është bërë i disponueshëm për palët përmes publikimit në faqen zyrtare, moment nga i cili fillon edhe afati 4-mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual.

18. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

19. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.